



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

QERSHOR, VITIT MËSIMOR 2017/2018

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat derisa të mos ju japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruani lexueshëm me shkronja dore.

Nëse shkruani me shkronja shtypi, theksojeni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar me rastin e zgjidhjes së detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon të përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- është e palexueshme dhe nuk është shkruar qartë përgjigjja
- është e shkruar me laps të thjeshtë
- është shkruar ose qarkuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

1. Lexo fragmentin nga dramatizimi i romanit Princi i vogël pastaj zhvillo detyrën.

(Princi i Vogël i kthehet dhelprës. Qëndrojnë për një çast në heshtje dhe ia shtrijnë dorën njëri-tjetrit për t'u përshëndetur.)

PRINC I VOGËL: Mirupafshim.

DHELPR: Mirupafshim... Ja sekretin tim. Është shumë i thjeshtë: - Vetëm me zemër shikohet mirë. Sytë nuk shikojnë atë që është me rëndësi.

PRINC I VOGËL (e përsërit): Ajo që është me rëndësi nuk shikohet me sy.

DHELPR: Kohën që e ke shpenzuar në trëndafilin tënd atë e bën aq të rëndësishme.

PRINC I VOGËL (e përsërit): Kohën që e kam shpenzuar në trëndafilin tim...

DHELPR: Njerëzit të njëjtën e kanë harruar, por nuk guxon ta harrosh. Përjetë je përgjegjës për atë që ke zbutur. Je përgjegjës për trëndafilin tënd.

A) Kush janë personazhet në fragment?

1 pikë	
--------	--

B) Nënvizoi didaskalitë në fragment.

1 pikë	
--------	--

2. Lexo vargjet e mëposhtme pastaj zgjidhe detyrën.

Tungjatjeta, nëna plakë,
Flokëbardha ime moj,
Qeshu, qeshu tinë pakë,
Përsëri të përqafoj...
O sa shumë ke ndryshuar,
Flokëbardha ime moj,
Rrullat ballin kanë shkruar
Pleqëria të pushtoi.
Po në ballin tënd të qetë,
Flokëbardha ime moj,
Shoh të shkruara dy jetë:
Një që erdhi, një që shkoi.

A) Përshkruaje vargun që ka përshëndetjen karakteristike nga vargjet e veçuar.

1 pikë	
--------	--

B) Cilën figurë stilistike hasim në vargun *Flokëbardha ime moj*?

1 pikë	
--------	--

FIORIN – monedhë prej argjendi ose floriri e cila është farkuar në Firencë nga shekulli XIII. Në faqen e saj ka pasur lulen e zambakut, sipas të cilës e ka marrë edhe emrin. Nga shekulli i XIV fiorini prej floririt është farkuar edhe në Hungari, kurse prej shekullit të XVI filloi ta përdor edhe Austria. Fiorin në Hungari quhej forintë, ndërsa në Austri gulden. Monedhë zyrtare e Austrisë, fiorini ka qenë nga viti 1848 deri në vitin 1892. Fiorini ndahej në njëqind krajcerë. Fiorini nga dekadat e para të shekullit XX bëhet edhe monadha më e pranishme në Mal të Zi. Buxheti shtetëror i Malit të Zi nga dekadat e para të shekullit XIX llogaritej në fiorinë, dhe të gjithë zyrtarët shtetëror merrnin pagat në atë valutë. Shteti i Malit të Zi nga viti 1901 shfrytëzonte fiorinin si mjet kryesor përlllogaritës dhe të pagesës. Fiorini në Mal të Zi përlllogaritej sipas kursit i cili vlente në Austri.

FRANETOVIQ – Dinko (Hvar 1892 – Hvar, 1964) – kapiten i detarisë, historiograf. Ka filluar karrierën e detarisë në vitin 1911 në aniet transatlantike. Është pjesëmarrës i kryengritjes së njohur të marinarëve në Bokën E Kotorit (1-3.2.1918). Si udhëheqës i portit në Ulqin dhe më vonë, si anëtarë i komisionit për vendosjen e fenerit të detit, me përkushtim dhe me vetëiniciativë ka punuar në hulumtimin profesional të rrethanave nautike, meteorologjike dhe të peshkatarëve në Tivar, Ulqin, në Liqenin e Shkodrës dhe në Bunë. Pas punës së ndërgjegjshme dhjetëvjeçare, në burimet e pabotuara arkivore, botoi një vepër mjaft voluminoze me titull Historia e detarisë dhe peshkatarisë së Malit të Zi deri në vitin 1918 (1960).

3. Faqja e dhënë është nga:

1. Fjalori i fjalëve të huaja
2. Leksikoni historik
3. Leksikoni i shprehjeve letrare

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

4. Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë, rretho P.

KONSTATIMI		
Fiorini është emërtuar sipas Firencës.	S	P
Fiorini në Austri është përdorur nga viti 1848.	S	P
Në Mal të Zi fiorini është përlogaritur sipas kursit i cili vlente në Austri.	S	P
Fiorini është farkuar nga shekulli 14.	S	P

1 pikë

5. Fiorini në Hungari quhej forinta, kurse në Austri gulden. Këta të tre emërtime kanë:

1. domethënie antonimi
2. domethënie homonimi
3. domethënie sinonimi

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

6. Në cilin vend të punës në Ulqin punonte Dinko Franetoviq?

1 pikë

7. Cilin vit Dinko Franetoviq e ka botuar veprën e vet „Historia e detarisë dhe peshkatarisë...“?

1 pikë

Lexo me kujdes tekstin pastaj zhvillo detyrat 8, 9, 10 dhe 11.

PËRRALLA PËR DJALOSHIN E URTË ROM

Njëherë e një kohë, në një fshat prapa tetë maleve, jetonte një hoxhë i moshuar dhe i mençëm. Shumë të mira i kishte bërë në jetë, u kishte ndihmuar të varfërve dhe të sëmurëve, por duke kaluar vitet ishte bërë egoist dhe mendjemadh. Një herë dëgjoi hoxha se njerëzit në fshat e lavdëronin shumë një djalë të urtë rom, duke thënë se ai, edhe pse i vogël, është më i mençur se të gjithë fshatarët. Hoxha nuk ishte i kënaqur me këtë dhe vendosi t'u dëshmojë se ai djalosh nuk ishte edhe aq i mençur.

Duke shëtitur nëpër fshat, e atakoi atë djalosh i cili lozte me moshatarët e tij. Iu afrua fëmijëve dhe e pyeti mu atë:

– A je ti ai djaloshi i zgjuar për të cilin flet i tërë fshati? Je aq i zgjuar saqë, thonë, se mund t'ia kalosh edhe dijetarit me urti!

Djali e ndërpreu lojën, ngadalë iu kthye hoxhës dhe ju përgjigj:

– Unë këtë nuk e di, hoxhë i nderuar! Njerëzit çfarë nuk flasin, nuk duhet besuar gjithmonë çdo fjale.

– E kur je aq i mençur, duhet edhe ta dëshmosh. (...)

...pastaj hoxha dinak në fund propozoi:

– A do të luajmë symbyllazi? Nëse më gjen të tri herët, atëherë ti do të mbetesh në fshat, dhe nëse nuk më gjen, do të ikësh përgjithmonë nga fshati.

Hoxha shpejt u fsheh në fund të oqeanit të errët, duke menduar se djaloshi nuk do të kujtohet që ta kërkojë atje. Megjithatë, këtij shtatëvjeçarit të zgjuar nuk iu nevojiti shumë kohë që ta gjejë.

(Herën e dytë është fshehur në nofullat e peshkut, kurse herën e tretë në shpellën e Bjeshkës së Dragoit. Djaloshi e gjeti lehtë. Kur ishte rendi i hoxhës të kërkonte, djaloshi i tha se do të fshehë vetëm një herë, gjë që e kënaqi hoxhën. Djaloshi u fsheh në zemrën e hoxhës.)

Hoxhës iu morën mendtë nga kërkimi i fuqishëm, dhe pranoi se ka humbur. Papritmas, djaloshi u shfaq dhe me një qetësi i tha hoxhës:

– Sot, hoxhë, ke humbur, sepse, ka kohë që ke harruar në zemrën tënde. Ka kohë që nuk ke shikuar në të, e as që ia ke vënë veshin.

8. Cili tipar i hoxhës është motiv lëvizës i kësaj përralle?

1 pikë	
--------	--

9. Shkruaji dy karakteristika të cilat këtë tekst e bëjnë një përrallë.

2 pikë	
--------	--

10. Gara në mes të hoxhës dhe djaloshit është diçka më tepër se një lojë e thjeshtë symbyllazi. Shpjegoje konstatimin e dhënë.

2 pikë	
--------	--

11. A) Porosia e përrallës është fjalia:

1. Njerëzit çfarë nuk flasin, nuk duhet besuar gjithmonë çdo fjale.
2. Sot ke humbur, sepse, ka kohë që ke harruar në zemrën tënde.

Rretho numrin para përgjigjes e cila mendon se është e saktë.

B) Shpjegoje përgjigjen.

2 pikë	
--------	--

12. Rretho numrin para llojit letraro-shkencor.

1. Vetëm plepi krenar me gjethet e thata pëshpëritë për jetën e errët dhe të shurdhër sikur është i vetmuar në mes të gjithësisë.
2. Mbreti duke parë se vajza ishte shumë më e urtë se ai, urdhëroi që ta sjellin para tij...
3. Shkrimtari amerikan Mark Tuen është njëri nga humoristët më të mëdhenj në letërsinë botërore. Emri i vërtetë i tij është Semjuell Klemens. Lindi në Misuri në nëntor të vitit 1835. Një nga veprat më të njohura të tij është *Përjetimet e Tomë Sojerit*...

1 pikë	
--------	--

13. „Njëherë e një kohë, në një fshat prapa tetë maleve...”

Shprehjen „prapa tetë maleve” zëvendësoje me një fjalë.

1 pikë	
--------	--

14. Iu afrua fëmijëve dhe e pyeti mu atë: “A je ti ai djaloshi i zgjuar për të cilin flet i tërë fshati?”

Ligjëratën e drejtë kaloje në ligjëratë të zhdrejtë.

1 pikë	
--------	--

15. Djali e ndërpreu lojën, ngadalë iu kthye hoxhës dhe ju përgjigj: “Unë këtë nuk e di, hoxhë i nderuar!”

Fjalëve të nënvizuara caktoju rasën.

lojën _____

hoxhës _____

hoxhë i nderuar _____

2 pikë

16. „Nëse më gjen të tri herët atëherë ti do të mbetesh në fshat.“

A) Shkruaje presjen atje ku duhet të jetë në fjali.

1 pikë

B) Sqaroje përdorimin e presjes në fjalinë e dhënë të zgjeruar.

1 pikë

17. Goja e gjyqtarit plak u shtrembërua duke shprehur pakënaqësinë e tij.

Foljes së nënvizuar nga fjalia e dhënë gjejani mënyrën dhe kohën.

Mënyra: _____

Koha: _____

2 pikë

18. „...këtij shtatëvjeçari nuk iu nevojit shumë kohë...”

A) Fjala e nënvizuar është:

1. numëror
2. emër
3. mbiemër

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

B) Falën e përbërë të nënvizuar shkruaje si kombinim të numrit dhe fjalës.

1 pikë

19. Shëno autorin e veprës dhe gjininë letrare të saj.

VEPRA	AUTORI	GJINIA LETRARE
<i>Shpella e piratëve</i>		
<i>Bababa – Tomorri</i>		
<i>Xha Gorio</i>		

3 pikë

A series of horizontal lines for writing, consisting of 10 dashed lines at the top and 20 solid lines below.

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2018